

▪ Panairi "Work and Study"



Në datat 17-29 Shtator 2010, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë organizoi Panairin "Work and Study". Universitete shqiptare jo-publike, Agjensi Punësimi dhe kompani të tjera ishin pjesëmarrëse në këtë panair.

Në ceremoninë e hapjes ishin të pranishëm zv.Ministrja e Arsimit dhe Shkencës, znj.Nora Malaj dhe zv.Ministrja e Punëve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, znj.Filloreta Kodra.

Pjesëmarrja e FASTIP në këtë panair u mundësua falë mbështetjes së Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë dhe veçanërisht Kryetarit të kësaj Dhome, z.Nikolin Jaka. Gjatë një konference së mbajtur në një nga ditët e panairit, iu kushtua vëmendje e veçantë promovimit të FASTIP si një risi në arsimin e lartë publik në vend. Gjatë fjalës së tyre, pjesëmarrësit në konferencë vunë theksin në suksesin e plotë të arritur mes sektorit publik dhe privat të implementuar më së miri nga modeli FASTIP.

Përveç promovimit, FASTIP arriti të lidhë edhe disa marrëveshje bashkëpunimi me kompani të cilat nuk u kursyen të shprehnin interes për bashkëpunim dhe partneritet të ndërsjellë.

Faleminderit Work and Study Fair!

